



01/Nr. 10267/2023
Data : 11.12.2023

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e njëmbëdhjetë -XI- për vitin 2023 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 20.11.2023 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Informim) .

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për pronat komerciale.
3. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.
4. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për pronat komerciale.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- Ministria e Financave, Punës dhe transfereve në këtë vit ka bërë vlerësimin e përgjithshëm të pronave komerciale që ka të bëjë me objektet dhe parcelat. Në raport i keni të gjitha të dhënat nga ky raport si për tokat komerciale si dhe për objektet të cilat janë të ndara me zona të ndryshme. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- shifra tridhjetë e një zero një parcelat për objektet komerciale shuma 200 € a llogaritet në bazë të metrit në katrorë apo në çfarë forme llogariten.

Lindita Ballazhi thekson:- është për metër katrorë dhe është vlerësim i departamentit të tatimit në pronë pasi që i kanë ndarë në pesëmbëdhjetë zona dhe sqarimet i keni më poshtë. Vlerësimi është bërë në bazë të kontratave të shitë blerjes që janë marr nga agjensioni kadastral i Kosovës, anketa kanë bërë me qytetarë dhe kanë arritur me një farë konkluzioni të cilin e kanë caktuar edhe nivelin e zonës.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI MBI VLERËSIMIN E PËRGJITHSHËM PËR PRONAT KOMERCIALE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kimete Kuka - Hasallari thekson:- Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për performancën në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “ Dr.Menduh Kaloshi” Qendrën Për Punë Sociale. Aktivitetet gjatë muajit Janar-Tetor në kuadër të DSHMS-së, Më 31.01.2023 kemi pranuar donacion nga kompania Ipko: aparaturë Ultrazë me vlerë 12,000€. Rregullimin e disa filterave të ngrohjes në QKMF. Kam përcjell në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Shëndetësisë kërkesën për shtim të stafit në QKMF. Rregullimin dhe riparimin e rrjetit elektrik ne objektin e QKMF-së. Ndërrimin e sanitarisë në QKMF. Janë dhuruar 100 pako ushqimore familjeve në nevojë nga Arabia Saudite në bashkëpunim me organiztën Bereqeti. Janë dhuruar 300 pako ushqimore për familjet në nevojë nga organizata Qatar Charity. Me 20.04.2023 kemi bërë pranimin e donacionit nga kontingjenti i KFOR-it Italian të paneleve solare 12 kw për kursim të energjisë elektrike në QKMF. Përmes CARITAS-it kemi kontraktuar për shërbime shëndetësore, katër infermier dhe një mjekë i përgjithshëm. Nga data 05.07.2023 kemi bërë dezinfektimin dhe deratizimin e gjitha institucioneve publike në komunën ton me përjashtim të institucioneve shkollore ku do të realizohet në fund të muajit gushtë. Kemi rishpallur procedurat e projektit “Ndërtimi i depos në QKMF”. SHARRCEM ka mbështetur edhe për gjashtë muaj stomatologun dhe infermieren. Më 02.06.2023 kemi mbajtur aktivitetin e dhurimit të gjakut, rreth 133 dhurues. Më 27.06.2023 organizata Humany First Kosova kanë dhuruar 60 pako me produkte të mishit për 60 familje ne nevojë. Më 29.06.2023 nga organizata Qatar Cherity janë shpërnda 100 pako me mish për familjet në nevojë. Është bërë dezinfektimi i gjitha hapësirave në Komunën e Hanit të Elezit në tri faza. Kemi nënshkruar marrëveshjen me Islamik Relief për mbështetjen me staf. Është bërë pastrimi i gjitha hapësirave në QKMF. Kanë filluar punimet e depos së QKMFS-së. Janë mbajtur aktivitete të shumta gjatë muajit Rozë për ndërgjegjësimin e sëmundjes së Kancerit të gjirit si: ekskursion një ditë me gratë e prekura me kancer të gjirit, ligjërata në disa fshatra dhe marrëveshjen me Spitalin Rajonal të Ferizajt të mamografis për 20 gra të komunës sonë.

Sherif Berisha thekson:- te furnizimi i rregullt me barna ka ankesa prej qytetarëve për mungesë të barnave. Përcjellja e punës dhe funksionimi i AMF-së, ku e dimë që QKMF nuk ka mjekë në orarin e ditës, as për vizita shtëpiake e lere më për AMF-në në fshatin Gorancë. Pse mjeku nuk shkon në vizitë në fshatin Gorancë. Te bashkëpunimi i DSHM-së me subjektet e tjera komunale çfarë nënkuptoni. Rritjen e vizitave shtëpiake për nënat dhe fëmijët deri në tre vite. A dihet numri i saktë i mjekëve sepse dy mjek janë larguar nga puna , ndërsa në tabelarë figuron se janë gjashtë mjekë në QKMF. Pse kaq shumë rritje të shërbimeve në këtë periudhë në krahasim me periudhën e vitit të kaluar. Pse në muajin mars nuk keni pasur asnjë shërbim të rëntgenit. AMF në fshatin Gorancë nuk ka funksionuar në mënyrë normale për shkak se kemi 250 shërbime më pak se nga viti 2022. Përveç muajit rozë çka keni ndërmar për gratë me kancer të gjirit.

Kimete Kuka - Hasallari thekson:- te furnizimi me barna zakonisht furnizohemi nga Ministria e Shëndetësisë por përveç kësaj kemi edhe kompaninë që në mungesë të barnave nga Ministria furnizohemi prej barnatores private me të cilën e kemi kontratën por fatkeqësisht edhe barnatoret janë në mungesë të barnave me barnat që na i kërkojmë sepse është problem i përgjithshëm nëpër barnatore. Te AMF-ja nuk kemi mjekë shkaku i mungesës së mjekut në QKMF dhe ju e dini që kemi bërë marrëveshje për punë vullnetare për dy mjekë të komunës sonë por me infermierë është vazhdimisht shkaku për një matje të tensionit, shpërndarjen e disa barnave për qytetarët atje që për mos me i munduar me ardhur në QKMF. Bëhet fjalë për QKMF-në me akterët tjerë lokal brenda komunës. Është program që është i inkorporuar përmes mjekësisë familjare që e kemi përmes UNICEF-it që të realizohen dhe janë të parapara se sa vizita në vit me u bërë tek nënat dhe foshnjat e porsalindura deri në moshën tre vjeçare . Kjo bëhet përmes plan programit që na i përcjell UNICEF-i dhe ne e realizojmë. Procedurat i kemi filluar për dy mjekë që kanë dhënë dorëheqje dhe tash po presim edhe me mjekët të cilët janë përzgjedhur prej Islamik Reliefin. Informata përfshihet prej muajit Janar deri në muajin Tetor. Rritja e shërbimeve është për shkak të viruseve sezonale . Në muajin mars kemi pasur defekt te rëntgeni dhe e kemi rregulluar. Për AMF-në në fshatin Gorancë arsyet i tregova sepse jemi në mungesë të mjekut deri sa të bëhet rekrutimi i mjekëve. Kërkesë kemi bërë në Ministri që të jetë mamografia për ata gratë që ka qenë sikur vitin e kaluar por shkaku i komunave të tjera që nuk e kanë pasur në dispozicion nuk na e kanë lejuar edhe neve si komunë që ta kemi edhe në këtë vit por kam kontaktuar me drejtorin e DSHM-së së Ferizajt dhe spitali rajonal najë ka mundësuar për 20 gra me bërë mamografi falas të cilat jemi duke i dërguar nga katër gra në ditë.

Kryesuesi thekson:- është e vërtetë që është numri i vogël i stafit dhe nëse është një person që punon te rëntgeni nuk do të ishte mirë me caktuar në punë në ndërrim të natës.

Kimete Kuka - Hasallari thekson:- është përgjegjësi e drejtorit të QKMF-së por shqetësimet të cilat i kam marr në mbledhje të kuvendit ja kam paraqitur drejtorit të QKMF-së sepse besoj që ka infermier të mjaftueshëm që mos me zëvendësuar me përgjegjësin e rëntgenit.

Refet Kalisi thekson:- potencuat që për barna esenciale kemi kontratë me barnatore private dhe është e pa mundur që mos me i pasur barnatorja private ato barna esenciale.

Kimete Kuka - Hasallari thekson:- porosia prej departamentit vjen me vonesë edhe te na dhe ndodhë arsyeja e vonesës edhe te na .

Ibadete Kalisi thekson:- është mirë që barnatoret me punuar gjatë natës.

Kimete Kuka - Hasallari thekson:- për këtë çështje duhet ta ndryshojmë rregulloren.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATI MBI GJENDJEN NË SHËNDETËSI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Refet Kalisi thekson:- shqetësimin e kam potencuar edhe më herët për çështjen e ujit sepse ujë ka tash por është problemi i rrymës. Ditën e shtunë për shkak të problemit të rrymës ujë nuk ka pasur tërë ditën dhe duhet me bërë zgjidhje për çështje të agregatit sepse duhet urgjent për shkak se fabrika punon me rrymë .

Sherif Berisha thekson:- edhe unë jam në dakord me atë që potenco i parafolësi dhe është mirë që në mbledhje të kuvendit Kryetari të na njofton për këtë çështje. Te Ura e Seçishtës një dritë nuk është tu funksionuar , është mirë të riparohet.


Hisni Luri thekson:- çdo manifestim që kemi mbajtur e kemi pasur një këshill organizativ dhe është kërkesë e Kryetarit që me plotësuar me shefat e grupeve parlamentare që si informim me ditë se si do të organizohet për shkak se si drejtori kemi pasur telashe të mëdha te pjesa e kulturës sepse buxheti drejtorisë së arsimit ka qenë buxhet specifik. Për datën njëzet e tetë nëntor do të bëhen homazhe te Varrezat e Dëshmorëve në Pustenik, promovimin e dy librave që i kemi subvencionuar si komunë të shkrimtarit tanë z.Fadil Curri dhe z.Shaban Çupi , manifestimi kulturorë prej SHKA “Sharri” , do të ketë turnirë në volejball në mes të institucioneve.

Ibadete Kalisi thekson:- shumica dritave në fshatin Seçishtë nuk janë tu bërë është mirë me u rregulluar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:48.

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

